



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. ____ prot.

Tiranë, më 25.7.2023

Lënda: Bisedimet përfundimtare të Komisionerit Publik, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për çështjen ankim kundër vendimit 621, datë 13.2.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Erabër Madhi

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303, të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha kërkimet dhe prapësimet e palëve, si dhe provat e administruara, Komisioneri Publik, duke iu qëndruar parashtrimeve me shkrim të depozituara në seancën gjyqësore të datës 4.7.2023, në mënyrë të përmbledhur, vlerëson se:

I. Për shkakun ankimor për vlerësimin e pasurisë:

1. *Bono thesari me vlerë 4.000.000 lekë dhe apartament banimi me sipërfaqe 124,27 m², me çmim blerje 16.776.450 lekë, pasuri në vlerë totale prej 20.776.450 lekë, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të tyre, pasi rezultojnë këto rrethana objektive:*

1.1 Në emër të znj. ***.*** (nëna e subjektit të rivlerësimit) rezulton investimi në *bono thesari* i kryer në vitin 2009 dhe investimi në pasurinë *apartament me sipërfaqe 124,27m²*, i kryer në vitin 2012, për të cilat si burim krijimi deklarohet se janë kursimet nga të ardhurat e përfituara nga puna e të atit, i cili ka ndërruar jetë në vitin 2005.

1.2 Subjekti i rivlerësimit ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare me znj. ***.***, për periudhën minimalisht prej datës *.5.2005 – *.4.2012¹, dhe është larguar nga përbërja familjare vetëm katër ditë pas transaksionit të blerjes së apartamentit nga nëna e tij. Rrjedhimisht, të dyja pasuritë në analizë rezultojnë të krijuara nga nëna e subjektit gjatë kohës që ky i fundit ka qenë në të njëjtën përbërje familjare me të dhe në funksionin gjyqtar².

¹ Referohuni shkresës së Gjendjes Civile nr. *** prot., datë *.6.2022.

² Në Gjykatën e Rrethit Fier deri në tetor 2005 dhe Rrethit Vlorë deri në vitin 2013.

1.3 Investimi i znj. ***.*** në pasuri të luajshme dhe të paluajshme rezulton në vlerë të konsiderueshme dhe, bazuar në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, të ardhurat nga pagat e znj. ***.*** nuk mund të jenë të mjaftueshme për të mbuluar investimin e këtyre pasurive.

2. Bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, në pyetëtorin e datës 19.4.2022, se këto pasuri janë krijuar me kursime nga të ardhurat e realizuara nga babai i subjektit, trashëguar nga e ëma, znj. ***.***, pas vdekjes së tij në vitin 2005, nga verifikimi i akteve në dosje, rezulton se të ardhurat e ligjshme të realizuara nga punësimi i të atit, provuar me dokumentacion, janë në vlerën rreth 1.898.399 lekë, të cilat nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar investimet e nënës së subjektit në vitet 2009 dhe 2012, llogaritur në vlerën totale 20.776.450 lekë.

3. Të ardhurat e pretenduara nuk u provuan as nga hetimi administrativ i Komisionit, ndërkohë Ministria e Mbrojtjes ka konfirmuar se nuk i ka paguar të atit të subjektit pagesa shtesë për pjesëmarrjen në misione. Pretendimi i subjektit mbi të ardhurat e përfituara nga i ati në formë dietash, përveçse i paprovuar, është edhe në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit, mbi trajtimin e të ardhurave në formën e dietës.

4. Pretendimet e subjektit mbi të ardhurat e përfituara nga i ati nga institucionet ndërkombëtare, në vlerën totale prej rreth 511.000 USD, mbetën në nivel deklarativ dhe të paprovuara edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj.

5. Lidhur me të ardhurat financiare të të atit të subjektit të rivlerësimit nga puna pranë organizatave ndërkombëtare, u administrua nga ana e trupit gjykues të Kolegjit, në seancën gjyqësore të datës 19.7.2023, akti noterial me nr.*** rep., datë **.7.2023, i noteres ***.***, Dega Vendore Tiranë, me anë të cilit vërtetohet dhe verifikohet si kopje e njëjtë me dokumentin elektronik: “*e-mail, Sekretare misioni NATO, albmission.nato@mfa.gov.al to *** date: ** July 2023; 1:17:50 PM, ****”, 2 fletë.

5.1 Nga përmbajtja e këtij komunikimi elektronik, me dërgues z. ***.***, me detyrë të paspecifikuar, pranë Zyrës së Ambasadorit, Delegacioni i përhershëm i Republikës së Shqipërisë në NATO, konfirmohet se: “nuk është mundur të merret asnjë përgjigje zyrtare mbi kërkesën në lidhje me punësimin ose marrëdhëniet kontraktuale financiare që z. ***.*** ka patur me këtë organizatë... si dhe ...për çdo informacion që do të mund të marrim në të ardhmen, do t’ju kontaktojmë menjëherë”.

5.2 Nga kjo korrespondencë në formatin elektronik, gjendja faktike e referuar në ankimin e datës 23.3.2023 të Komisionierit Publik dhe parashtrimet e paraqitura në seancën gjyqësore të datës 4.7.2023, mbetet e njëjtë dhe e pandikuar.

5.3 Gjithashtu, nisur nga shuma e konsiderueshme e të ardhurave dhe kursimeve të pretenduara, mbetet e paprovuar mënyra e krijimit dhe ruajtjes së tyre, si rrjedhojë, mbetën të paprovuara dhe kursimet e pretenduara të trashëguara nga nëna e subjektit pas vdekjes së babait të subjektit.

6. Gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, të pasqaruara mbetën dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit mbi vendqëndrimin e tij gjatë periudhës 2004-2019, trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 23.3.2023.

7. Komisioneri Publik vlerëson se rrethanat faktike janë të tilla që të krijojnë bindjen se znj. ***.*** nuk kishte burime financiare të ligjshme, për krijimin e pasurive si më sipër, në

vlerën 20.7776.450 lekë dhe subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj.

7.1 Sjellim në vëmendje të Kolegjit dhe faktin se pasuria *apartament me sipërfaqe 127.27 m²* e blerë nga znj. ****.****, duket që nuk është shfrytëzuar asnjëherë prej kësaj të fundit nga momenti i blerjes e deri në ndërrimin e jetës.

8. Në përfundim, Komisioneri Publik, referuar situatës faktike të përshkruar më sipër, deklarimeve të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe bazuar edhe në aktin: “Rekomandim për paraqitje ankimi”, të datës 9.3.2023, vlerëson se gjithë sa më sipër, parë në harmoni dhe me deklaratimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit mbi adresat e banimit gjatë periudhës 2005-2016, çojnë në përfundimin se kemi të bëjmë me përpjekje të subjektit të rivlerësimit për të fshehur pasuritë, duke e vendosur këtë të fundit në kushtet e nenit D, pika 5 e aneksit të Kushtetutës, dhe cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

II. Kërkimi përfundimtar i ankimit

9. Komisioneri Publik, mbështetur në sa më sipër trajtuar, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 621, datë 13.2.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Erarbër Madhi.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO